



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit mbi shoqërinë SPV, nga shoqëria Bimal d.d. Brčko.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.267 Prot., i AK, datë 27.05.2021 “Njoftim përqendrimi: Blerja e Eraković d.o.o, nga Bimal d.d. Brčko”- Njoftim në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës.”, me të cilën jemi njoftuar për nënshkrimin e marrëveshjes për shprehje interesi (marrëveshje mirëkuptimi) ku shoqëria Bimal d.d. Brčko do të blejë kuota të kapitalit të shoqërisë SPV/shoqëria e qëllimit, e cila do të themelohet nga shoqëria Eraković d.o.o.

Palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Bimal d.d. Brčko është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Bosnje dhe Hercegovinës, me objekt aktiviteti prodhimin e vajrave dhe yndyrave. Shoqëria është lider në prodhimin, përpunimin dhe shitjen e vajrave të farave, drithërave, vajrave ushqyesh në Bosnje dhe Hercegovina si dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Grupi Bimal është prezent dhe realizon të ardhura në Shqipëri, në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet shoqërisë Agrana-Studen Albania.

Agrana-Studen Albania, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti tregtimin me shumicë të sheqerit dhe prodhimeve të tjera ushqimore, si dhe veprimtari të tjera që kanë lidhje me tregtimin me shumicë/pakicë, distribucionin, logjistikën etj.

Target: SPV/shoqëria e qëllimit do të krijohet sipas legjislacionit serb nga shoqëria Eraković d.o.o, me aktivitet në fushën e prodhimit të ushqimeve të gatshme për kafshët shtëpiake.

Pala shitëse: Eraković d.o.o. është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit serb me objekt aktiviteti; tregtimi me shumicë i drithërave, duhanit të papërpunuar, farave dhe ushqimeve të gatshme për kafshët shtëpiake.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.